



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 735/2 Prot.

Tiranë, më 13.07.2021

V E N D I M

Nr.100, datë 13.07.2021

Mbi përfundimin e hetimit administrativ nisur me Urdhrin me nr. 50 datë 07.07.2021, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil “Për verifikimin e informacionit të marrë nëpërmjet medias, i publikuar në emisionin investigativ “Fiks Fare”, i transmetuar në datën 6.07.2021 në kanalën televiziv kombëtar “Top Channel”, në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë të emërimit të punonjësit ***, në pozicionin e punës “Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Komunitare dhe Administrative”, pranë Bashkisë Kukës**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

VËREJ SE:

Në emisionin investigativ “Fiks Fare”, të datës 06.07.2021, të publikuar në televizionin kombëtar “Top- Channel”, është ngritur pretendimi se, punonjësi ***** me detyrë “Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Komunitare dhe Administrative”, pranë Bashkisë Kukës, është emëruar në këtë pozicion në kundërshtim me ligjin, pasi rezultoi që të jetë i dënuar penalisht me dy vendime të formës së prerë nga gjykata, për kryerjen e disa veprave penale.

Në vijim, sipas informacionit të parashtruar në denoncim, pretendohet se ky punonjës nuk duhet të ushtrojë detyrën e *“Drejtorit e Drejtorisë së Shërbimeve Komunitare dhe Administrative”*, pranë Bashkisë Kukës, pasi legjislacioni i vendit parashikon se, për të kryer funksione publike, punonjësi duhet të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e një krimi, si edhe të mos jetë i dënuar për kundravajtje penale të kryer me dashje.

Pas transmetimit të faktit të evidentuar më sipër, Komisioneri, me Urdhrin nr. 50, datë 07.07.2021, *“Për verifikimin e informacionit të marrë nëpërmjet medias, i publikuar në emisionin investigativ Fiks Fare, i transmetuar në datën 06.07.2021, në kanal televiziv kombëtar Top-Channel”*, filloi kryesisht verifikimin e këtij rasti.

Nga verifikimi i dokumentacionit, i administruar në rrugë elektronike nga Komisioneri dërguar nga Bashkia Kukës, si dhe nga komunikimi me nëpunësin ******, me detyrë *“Përgjegjëses së Sektorit të Burimeve Njerëzore”*, në Bashkinë Kukës, rezultoi se :

Me urdhrin nr. 116, datë 02.09.2019, të kryetarit të Bashkisë Kukës *“Për emërim në detyrë”*, është vendosur emërimi i punonjësit ******, në pozicionin *“Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike”* në këtë institucion. Këtë funksion ky punonjës e ka vazhduar deri në datën 07.07.2021, ku me urdhrin nr. 372, të Kryetarit të Bashkisë Kukës, është vendosur *“Pezullimi nga detyra”*, pas publikimit të rastit në fjalë, në televizion.

Duke analizuar në tërësi strukturën dhe organikën e Bashkisë Kukës, konstatohet se pozicioni i punës *“Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike”*, përfshihet në fushën e veprimit të shërbimit civil dhe për këtë arsye, marrëdhënia e punësimit në këtë pozicion pune duhet të lidhet në zbatim të procedurave ligjore, sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.

Nisur nga pretendimet e publikuara dhe pas analizës së dokumentacionit të administruar në kuadër të hetimit administrativ të këtij rasti, rezulton se emërimi i punonjësit ******, në pozicionin *“Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike”*, nuk është kryer sipas parashikimeve ligjore, që në këtë rast, për nivelin e mesëm drejtues, ku përfshihet pozicioni i punës *“Drejtor Drejtorie”*, në kuptim të nenit 19, të ligjit për nëpunësin civil, kërkon zbatimin e procedurës së lëvizjes paralele; ngritjes në detyrë, apo pranimit nga jashtë shërbimit civil sipas procedurave të caktuara ligjore, të parashikuara nga neni 26, i ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.

Fakti që punonjësi është marrë në punë në kundërshtim me ligjin për nëpunësin civil, ka bërë që ai të mos kalojë nëpërmjet procesit të verifikimit, si në momentin e parë të shqyrtimit nga njësia përgjegjëse të dokumentacionit që provon përmbushjen e kërkesave të përgjithshme dhe të posaçme të punonjësit për të qenë pjesë e shërbimit civil, ashtu edhe në fazën e deklaramentit të gjendjes së tij gjyqësore, nëse do të shpallej fitues pas konkurrimit.

Sa më sipër, Kryetari i Bashkisë Kukës, ka vepruar në kundërshtim të hapur me ligjin, duke e emëruar punonjës në fjalë, me një akt të thjeshtë emërimi, në një pozicion pune që është pjesë e shërbimit civil, pa zhvilluar më parë procedurat e kërkuara ligjore në këtë rast, ç'ka, në vështrim të nenit 108, pika ii) të germës a), të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, e bën aktin absolutisht të pavlefshëm. Në këto rrethana, sipas nenit 110, pika 1, të ligjit në fjalë, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo, si i tillë.

Për të gjitha sa u analizuan më sipër, bazuar në nenin 26 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nenin 110 dhe nenin 111, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Kukës, duhet të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit të emërimit të punonjësit ******, si akt administrativ i nxjerrë në kundërshtim me procedurën e kërkuar nga ligji për shërbimin civil.

Nga ana tjetër, njësia përgjegjëse duhet të drejtojë procesin e rregullimit të ligjshmërisë duke ndërprerë menjëherë marrëdhënien e punës për punonjës ***** dhe duke shpallur procedurën e konkurrimit për plotësimin e pozicionit të punës "Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike", sipas kërkesave të ligjit për nëpunësin civil.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Kukës, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit të emërimit nr. 116 datë 02.09.2019, “Për emërim në detyrë”, për punonjës ***** në pozicionin e punës “Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike”, si një akt absolutisht i pavlefshëm, i nxjerrë në kundërshtim flagrant me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.
2. Njësia përgjegjëse, duhet të drejtojë procesin e rregullimit të ligjshmërisë, për rastin e emërimit në kundërshtim me ligjin të punonjës ******, si dhe në vijim të plotësojë pozicionin e punës që do të mbetet i lirë, me anën e procedurës së konkurrimit, sipas përcaktimeve të nenit 26 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij.

3. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 15 ditë, nga marrja dijani për këtë vendim.
4. Njësia përgjegjëse është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
5. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve, që nuk kanë kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha